



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:057870

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05592354

KPPP.nr.810/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kosmonte Foods SH.P.K., me seli në rr. "Lidhja e Pejës" nr. 289 Zona Industriale, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Edon Bibaj, avokat nga Prishtina, kundër debitorit The North Unicorn L.L.C, me NUI: 810112186, me seli në rr. "Zona Industriale", në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.101/23 të datës 27.04.2023, të Përmbartuesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit The North Unicorn L.L.C., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.101/23 të datës 27.04.2023, të Përmbartuesit Privat Eset Murati.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.101/23 i datës 27.04.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit Kosmonte Foods SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.101/23 të datës 27.04.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 110-81/979 të datës 07.02.2023; Faturës Nr. 110-81/978 të datës 07.02.2023; Faturës Nr. 112-81/764 të datës 23.02.2023; Faturës Nr. 112-81/766 të datës 23.02.2023; Faturës Nr. 112-81/760 të datës 22.02.2023; Faturës Nr. 112-81/759 të datës 22.02.2023; Faturës Nr. 112-81/756 të datës

20.02.2023; Faturës Nr. 112-81/751 të datës 22.02.2023; Faturës Nr. 112-81/753 të datës 20.02.2023; Faturës Nr. 108-81/1510 të datës 23.02.2023; Faturës Nr. 308-81/1137 të datës 21.02.2023; Faturës Nr. 108-81/1508 të datës 22.03.2023; Faturës Nr. 309-81/971 të datës 08.02.2023; Faturës Nr. 108-81/1498 të datës 20.02.2023; Faturës Nr. 310-81/950 të datës 07.02.2023; Faturës Nr. 310-81/945 të datës 06.02.2023; Faturës Nr. 108-81/1467 të datës 13.02.2023; Faturës Nr. 108-81/1462 të datës 11.02.2023; Faturës Nr. 108-81/1459 të datës 10.02.2023; Faturës Nr. 108-81/1456 të datës 10.02.2023; Faturës Nr. 602-81/1125 të datës 10.02.2023; Faturës Nr. 602-81/1131 të datës 10.02.2023; Faturës Nr. 312-81/449 të datës 09.02.2023; Faturës Nr. 312-81/451 të datës 09.02.2023; Faturës Nr. 312-81/453 të datës 09.02.2023; Faturës Nr. 312-81/457 të datës 16.02.2023; Faturës Nr. 312-81/458 të datës 16.02.2023; Faturës Nr. 312-81/460 të datës 20.02.2023 dhe Faturës Nr. 312-81/464 të datës 23.02.2023; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura, të ia paguaj kreditorit shumën prej 2,044.28 €, me kamatëvonesë prej 8%, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, me realizimin e përmbartimit përmes llogarive bankare të debitorit dhe përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke theksuar ndër të tjerash se me kreditorin kanë pasur marrëveshje furnizimi me produkte ushqimore, por që në rastin konkret propozimin e karakterizon parregullsia në përmbajtjen e tij, për shkak se janë paraqitur si dokumente të besueshme fatura të cilat nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar nga ana e debitorit dhe vulën e saj, për shkak se në të dhënat e ARBK-së, agjent i regjistruar është B.K. e në faturat e lartcekura nënshkrimet janë të panjohura për debitorin. Ka deklaruar se ka pagesa në vazhdimësi siç dëshmohet edhe nga pagesa e fundit e datës 30.01.2023 në vlerë prej 4,000.00 € e që në fakt flet qartë për seriozitetin dhe vullnetin e mirë që ka për t'i përmbushur obligimet e tij ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se të gjitha faturat e bashkëngjitura në propozim janë të pranuar nga ana e debitorit dhe të njëjtat janë dorëzuar në origjinal. Në lidhje me pagesat e dërguara nga ana e debitorit, ka theksuar se të njëjtat nuk janë të kontestueshme, por që në rastin konkret bëhet fjalë vetëm për faturat të cekura si në propozim, e që për këto fatura është dashur të sjell dëshmi bankare lidhur me pagesat e kryera. Gjykatës i

ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar, urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi dhe të detyrohet debitori që t'i mbuloj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore si dhe të gjitha shpenzimet e avokatit në bazë të TOAK.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 110-81/979 të datës 07.02.2023; Faturën Nr. 110-81/978 të datës 07.02.2023; Faturën Nr. 112-81/764 të datës 23.02.2023; Faturën Nr. 112-81/766 të datës 23.02.2023; Faturën Nr. 112-81/760 të datës 22.02.2023; Faturën Nr. 112-81/759 të datës 22.02.2023; Faturën Nr. 112-81/756 të datës 20.02.2023; Faturën Nr. 112-81/751 të datës 22.02.2023; Faturën Nr. 112-81/753 të datës 20.02.2023; Faturën Nr. 108-81/1510 të datës 23.02.2023; Faturën Nr. 308-81/1137 të datës 21.02.2023; Faturën Nr. 108-81/1508 të datës 22.03.2023; Faturën Nr. 309-81/971 të datës 08.02.2023; Faturën Nr. 108-81/1498 të datës 20.02.2023; Faturën Nr. 310-81/950 të datës 07.02.2023; Faturën Nr. 310-81/945 të datës

06.02.2023; Faturën Nr. 108-81/1467 të datës 13.02.2023; Faturën Nr. 108-81/1462 të datës 11.02.2023; Faturën Nr. 108-81/1459 të datës 10.02.2023; Faturën Nr. 108-81/1456 të datës 10.02.2023; Faturën Nr. 602-81/1125 të datës 10.02.2023; Faturën Nr. 602-81/1131 të datës 10.02.2023; Faturën Nr. 312-81/449 të datës 09.02.2023; Faturën Nr. 312-81/451 të datës 09.02.2023; Faturën Nr. 312-81/453 të datës 09.02.2023; Faturën Nr. 312-81/457 të datës 16.02.2023; Faturën Nr. 312-81/458 të datës 16.02.2023; Faturën Nr. 312-81/460 të datës 20.02.2023 dhe Faturën Nr. 312-81/464 të datës 23.02.2023; i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit, se në rastin konkret ka paguar disa detyrime sipas faturave kontestuese, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se debitori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi përmes së cilës do të mund të vërtetohej një fakt i tillë, meqenëse nga fletëpagesat e dorëzuara, nuk rezulton se borxhi i paguar ka të bëjë me faturat kontestuese për të cilat është iniciuar propozimi për përmbartim.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.810/23, datë 18.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.